REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:242913
Datë: 03.09.2021
Numri i dokumentit: 02141830

P. nr. 235/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. (E.) B. nga fshati K., Komuna e Drenasit, për shkak të veprës penale te vjedhjes se pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakove, me numër PP/II.nr.1315/ 2019, të datës 21.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më dt. 27.07.2021, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarit A. B., **më 27 korrik 2021 nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **A. B.** nga i ati E., e ëma Z., e lindjes M., i lindur me dt. ..., në fshatin K., të komunës së Gllogovcit, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ndërtimtari, i gjendjes së mesme ekonomike, i dënuar me parë, me numër personal ...

Në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

REFUZOHET AKUZA

Sepse,

Më datën 23.07.2019, rreth orës 19:30/h në rajon Rajonit Ekonomiko Pyjor “B.”, saktësisht në vendin e quajtur “B.”, me qellim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm i pandehuri me sharre matorikë ka prerë 143 copa dru edhe atë llojit “Bungu” me dimension prej 6m gjatësi, me diametër 8cm, e me vëllim te përgjithshëm prej 2.15 m³, me çka Drejtorisë për Bujqësi Zhvillim Rural - Njësia Pyjore në M. i shkakton dëm material në shumë prej 344.00 euro.

- me çka do të kryente veprën penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural Njësia Pyjore M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Gjakovë, më 21.10.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP/II. nr. 1315/19, te dt. 21.10.2019 kundër të akuzuarit A. B. nga fshati K., Komuna Drenas për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par .1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, në fjalën përfundimtare deklaron se pas administrimit të të gjitha provat në këtë shqyrtim gjyqësor si ato materiale dhe personale gjegjësisht pas deklarimit të dëshmitarit N. B., si roje e pyllit në vendin ku është kryer vepra penale e po ashtu edhe dëgjimi i të akuzuarit në ketë çështje penale kemi ardhur deri të një gjendje faktike që ndryshon përtej asaj që është përshkruar në aktakuzë pasi që në rastin konkret nga dëgjimi i dëshmitarit N. B., në këtë shqyrtim gjyqësor u vërtetua fakti se ne rastin konkret nuk është kontestueshëm qenë rajonin ekonomiko pyjor B. saktësisht ne vendin e quajtur B., janë vjedhur 2.15 m³ drunjë, në kohën dhe mënyrë e përshkruar si ne dispozitivin e aktakuzës, mirëpo nga dëgjimi i të dëshmitarit u vërtetu se këtu i akuzuari nuk ka qenë prezent ditën kur është kryer vepra penale po ashtu dëshmitari deklaroj se nuk e njeh të akuzuarin dhe se nuk është ai personi nuk është i akuzuari personi që ja ka dhe në të dhënat personal që i ka përshkruar në flet paraqitje duke shtuar së këtu të akuzuarin po e sheh për herën e parë në gjykatë, po ashtu dëshmitari deklaroj se nga personi që ja ka dhënë të dhënat personale nuk i është dhënë dokument identifikimi por të dhënat personal i janë dhënë gojarisht dhe se po ashtu dëshmitari në këtë shqyrtim gjyqësor e përshkroi fizikun e personi që ja ka dhënë të dhënat personale e që nuk përputhen me fizikun e këtu të akuzuarit, ndërsa po ashtu i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor mohoj kryerjen e veprës penale duke potencuar se ne vendin ku është kryer vepra penale asnjë herë nuk është hasur nga roja i pyllit dhe se nuk ka qenë ai personi që i ka prerë drenjë ne sasi prej 2.15m³. Andaj duke marrë parasysh faktin se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk është vërtetuar se këtu i akuzuari A. B., ka kryer veprën penale me te cilën ngarkohet pasi që nga provat e administruar gjegjësisht nga vet deklarimi i dëshmitarit u vërtetua se i njëjti nuk është hasur asnjë herë nga roja i pyllit duke prere drunjtë, dhe duke u gjendur ne këtë situatë meqenëse se nuk është vërtetua përgjegjësia penale nga i akuzuari për veprën penale më të cilën ngarkohet Prokuroria konform nenin 52 të KPPK-së, **TËRHIQET** nga aktakuza PP/II.nr.1315/2019 të datës 21.10.2019, ndaj të akuzuarit A. B. për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga nenin 349 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari A. B. deklaron se pajtohem me atë çka tha Prokurori i shtetit dhe nuk kam çka të deklaroj tjetër.

Prokurori i shtetit deklaroje se gjatë shqyrtimit gjyqësor **TERHIQEM** nga aktakuza PP/ll.nr.1315/2019 datë 21.010.2019, ndaj të akuzuarit A. (E.) B. për shkak të veprës

penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par .1 të KPRK-së. Gjykata në kuptim të neni 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së ku përcakton se: ***"Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri ne përfundim të shqyrtimit gjyqësor"***.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPPK-së, duhet refuzuar aktakuza kundër të akuzuarit të lartcekur për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par .1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 454 paragrafi 1 i KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga të lartcekurat dhe në bazë të nenit 363, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P. 235/2019, Datë 27 korrik 2021

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

2019:242914